



Ambasciata d'Italia
Tirana



unicef
for every child

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Mbështetje me bursë për të rinjtë në risk ose NEET ne arsimin e mesëm

Dokument orientues

Dritan Shano
Nëntor 2024



Përmbajtja

Lista e Shkurtimeve.....	2
I. Analiza e situatës	3
II. Nevoja për të përcaktuar përmasën e braktisjes në arsimin e mesëm të lartë.....	5
III. Efektet e braktisjes së shkollës së mesme të lartë.....	7
IV. Korniza strategjike dhe ligjore lidhur me braktisjen e arsimit në Shqipëri.....	9
4.1 Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026.....	9
4.2 Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030.....	10
V. Politikat aktuale të mbështetjes dhe financimi i tyre - si funksionojnë ato në praktikë.....	13
VI. Identifikimi i fëmijëve/adoloshentëve që braktisin shkollën dhe aktorët që përfshihen në këtë proces.....	16
VII. Propozimi për të mbështetur.....	19

Lista e Shkurtimeve

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
INSTAT	Instituti i Statistikave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MF	Ministrisë së Financave
NEET	Neither in education, employment or training/ Jo në Arsim, Punësim ose Trajnim
SKA 2021-26	Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
SKPA 2023-30	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVAP	Zyra Vendore Arsimore Para universitare

I. Analiza e situatës

Shqipëria gjendet sot përballë sfidave të rëndësishme demografike dhe socio-ekonomike, siç dëshmoi edhe censusi i vitit 2023. Vendi po përballet me një popullsi në plakje dhe shkallë të lartë emigracioni, veçanërisht mes të rinjve. Në këtë kontekst, bëhet gjithnjë e më urgjente nevoja për të zgjeruar mbështetjen financiare për nxënësit në rrezik braktisje të arsimit të mesëm të lartë, duke shkuar përtej politikave aktuale që mbulojnë vetëm arsimin e detyrueshëm deri në moshën 15 vjeç.

Argumenti për këtë zgjerim mbështetet në faktin se Shqipëria ende ka një mundësi, çdo ditë e më të kufizuar demografike me një popullsi relativisht të re krahasuar me vendet evropiane. Kjo paraqet një mundësi unike për të investuar në formimin e kapitalit njerëzor. Megjithatë, emigracioni i vazhdueshëm i të rinjve të arsimuar po krijon një drenim shqetësues të këtij kapitali. Propozimi për të siguruar mbështetje edhe për nxënësit e rrezikuar në arsimin e mesëm të lartë, njësoj si për ata në arsimin e detyrueshëm, synon të adresojë këtë sfidë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Përfitimet e pritshme nga ky investim janë të shumëfishta. Një forcë punëtore më e kualifikuar do të tërhiqte më shumë investime të huaja dhe do të rriste produktivitetin, duke gjeneruar më shumë kontribute në sigurime shoqërore - thelbësore për të përballuar nevojat në rritje të një popullsie që plakët. Për më tepër, arsimi i përmirësuar mund të ndihmojë në krijimin e mundësive në nivel lokal, potencialisht duke reduktuar presionin për emigracion. Në rastet kur të rinjtë zgjedhin të emigrojnë, një nivel më i lartë arsimor do t'i poziciononte ata më mirë për punë të kualifikuar jashtë vendit, duke rritur remitancat dhe mundësitë për transferim njohurish.

Investimi në arsimin e mesëm të lartë merr një rëndësi të veçantë kur shihet në prizmin e qëndrueshmërisë së sistemit të pensioneve. Duke zgjeruar mbështetjen financiare për të rinjtë në këtë nivel arsimor, qeveria mund të ndërtojë një forcë punëtore më të kualifikuar, e cila do të jetë në gjendje të gjenerojë të ardhura më të larta dhe rrjedhimisht kontribute më të mëdha në sigurime shoqërore. Kjo bëhet veçanërisht kritike në kontekstin e një popullsie në plakje, ku raporti mes kontribuesve aktivë dhe përfituesve të pensioneve po i largohet vazhdimisht raporteve optimale 3:1, apo edhe 2:1, raport i cili konsiderohet ende që siguron një mbulim të mjaftueshëm, por të rrezikuar. Në Shqipëri, në fund të vitit 2023 numri i kontribuesve raportohet në 826,928 persona, ndërsa numri i përfituesve ishte 705,000 persona, pra një raport i ulët 1:1.17. Një fuqi punëtore më e arsimuar dhe më produktive do të ishte më e aftë për të mbështetur përmes kontributeve të saj një numër në rritje të pensionistëve, duke ndihmuar kështu në përballimin e nevojave për mbulimin dhe axhustimin e pensioneve të pleqërisë. Në këtë mënyrë,

mbështetja për arsimin e mesëm të lartë shndërrohet në një investim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Nga këndvështrimi politik, ky zgjerim i mbështetjes arsimore përputhet me aspiratat e integritit në BE dhe Planin e Rritjes dhe Agjendën e Reformave 2024-2027. Ai demonstroi angazhimin e qeverisë ndaj mirëqenies familjare dhe lëvizshmërisë sociale, me potencial për të ndërtuar besnikëri politike afatgjatë. Zbatimi gradual, duke filluar me grupet më vulnerabël, do të lejonte vlerësimin e duhur të ndikimit duke menaxhuar kufizimet buxhetore.

Rezultatet e pritshme shtrihen në disa horizonte kohore. Në afat të shkurtër, pritet një mbështetje e rritur politike nga familjet dhe një perceptim më pozitiv publik. Në afat të mesëm dhe të gjatë, parashikohet përmirësim i treguesve arsimor, reduktim i shkallës NEET, një profil më i qëndrueshëm demografik dhe një forcë punëtore më konkurruese. Mbi të gjitha, kjo politikë përfaqëson një investim strategjik që ndërthur objektivat arsimore me sfidat demografike dhe aspiratën për zhvillim socio-ekonomik, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për të ardhmen e vendit.



II. Nevoja për të përcaktuar përmasën e braktisjes në arsimin e mesëm të lartë

Formulimi i politikave për të mbështetur fëmijët dhe të rinjtë që braktisin, apo janë në rrezik braktisje të arsimit të mesëm të lartë ka nevojë për një bazament të dhënash të konsoliduar. Kjo është e vlefshme për të kuptuar dinamikat e këtij fenomeni, shtrirjen, por dhe nevojën e mobilizimit të burimeve financiare që nevojiten për t'i aktualizuar këto politika. Institucioni i parë që përpunon të dhënat statistikore për braktisjen e arsimit të mesëm të lartë tek fëmijët dhe të rinjtë 15 – 18 vjeç në Shqipëri është Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Siç shihet dhe në tabelën e mëposhtme të dhëna – edhe pse të paplota dhe në nevojë për t'u shoqëruar me informacione në nivel vendor - që do mund të ndihmonin politikëbërjen janë të disponueshme përmes Vjetarit Statistikor të përvitshëm të MAS, deri për vitin shkollor 2017-2018.

Tabelë 1: Nxënës të regjistruar në vitin e parë në klasën X të vitit aktual shkollor.

Viti Akademik	Marrë Dëftesë në vitin aktual shkollor klasa IX		Regjistruar në vitin e parë në klasën X të vitit aktual shkollor		Tërheqja në %	
	Totali	Vajza	Totali	Vajza	Totali	Vajza
2011-2012 *	51317	25220	46925	22111	91.44	87.67
2012-2013 *	50380	24579	46354	21687	92.01	88.23
2013-2014 *	47823	24382	46536	21869	97.31	89.69
2014-2015 *	45462	21891	42306	19872	93.06	90.78
2015-2016 *	44001	21391	42072	19558	95.62	91.43
2016-2017 *	42828	21032	40645	19214	94.90	91.36
2017-2018 *	36546	17292	35286	16450	96.55	95.13
2018-2019 *	37985	18561	31842	15375	83.83	82.83
2019-2020 **	33618	16052			0.00	0.00
2020-2021 **	32176	15171			0.00	0.00
2021-2022 **	29911	14346			0.00	0.00
2022-2023 **						

* Tabela 24 e Vjetarit Statistikor për Arsimin, Sportin dhe Rininë 2018 - 2019

** Tabela 26 e Vjetarit Statistikor për Arsimin dhe Sportin 2021 - 2022

Një tjetër institucion që ofron të dhëna për fëmijët dhe të rinjtë e moshës 15-18 vjeç është Instituti i Statistikave (INSTAT), përmes treguesit NEET, i cili është ndër treguesit e matur nga ky institucion që prej vitit 2010. NEET përkufizohet si:

Treguesi për të rinjtë as në punësim, as në arsim dhe trajnim, shkurtimisht (NEET) korrespondon me përqindjen e popullsisë së një grupi të një moshe dhe gjinie të caktuar, të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë të përfshirë në arsim apo në ndonjë trajnim të mëtejshëm. Ky tregues i referohet personave që i plotësojnë këto dy kushte:

- ata nuk janë të punësuar (dmth të papunë ose joaktiv sipas definicionit të Organizatës Ndërkombëtare e Punës);
- ata nuk kanë marrë asnjë edukim apo trajnim në katër javë përpara vrojtimit. Emëruesi është popullsia e përgjithshme e së njëjtës grupmoshe dhe gjinie, me përjashtim të të anketuarve të cilët nuk janë përgjigjur pyetjes 'pjesëmarrjes në arsim dhe trajnim të rregullt

Të dhënat e INSTAT përfshijnë përqindjen e individëve të rinj NEET të kategorizuar sipas dy grupmoshave (15-24 dhe 15-29), gjinisë dhe nivelit arsimor. INSTAT ka një optikë më të fokusuar tek marrëdhënia me tregun e punës sesa brenda për brenda sistemit arsimor parauniversitar, kur mat NEETs në Shqipëri. *Për fat të keq, ka një mungesë informacioni për të rinjtë NEET që nuk janë aktualisht të regjistruar në arsim ose trajnime, të ndara më tej sipas moshës dhe gjinisë. Në fakt segmenti 15-18 vjeç që i përket fëmijëve apo adoleshentëve në arsimin e mesëm të lartë, zhduket brenda statistikave të NEET që na vijnë nga INSTAT.*

Për më tepër të dhënat janë vetëm në nivel kombëtar dhe identifikimi i këtyre të rinjve në termat e shtrirjes gjeografike (nivel rajonal apo lokal) brenda territorit shqiptar apo karakteristikave social-ekonomik është i pamundur me të dhënat publike që disponohen. Kjo e bën të vështirë jo vetëm hartimin e politikave të suksesshme për ta, por bën të pamundur identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve specifike dhe individuale për të përmirësuar statusin e tyre.

Informacion tjetër që do mund të përforconte, duke shtuar specifikimet – si për segmentin 15-18 vjeç që nuk matet nga NEET i INSTAT, ashtu dhe për shkallën e vulnerabilitetit që çon tek braktisja, apo rreziku për braktisje i arsimit të mesëm të lartë – mund të përftohen nga një sërë institucionesh që operojnë në nivel lokal. Kjo do të ndihmonte për t'u informuar mbi përmasën aktuale të nivelit të braktisjes së arsimit të mesëm të lartë dhe pasojave sociale dhe ekonomike që ky fenomen përfaqëson.

III. Efektet e braktisjes së shkollës së mesme të lartë

Një nga sfidat më të mëdha në adresimin e braktisjes së shkollës mes grupmoshës 15-18 vjeç është pikërisht vështirësia në identifikimin dhe gjurmimin e këtyre të rinjve, të cilët shpesh "zhduken" brenda statistikave më të gjera të grupit NEET (të rinj që nuk janë në arsim, punësim apo trajnim). Kalimi nga braktisës potencial i shkollës në pjesëtar të grupit NEET ndodh shpesh në mënyrë të padukshme dhe progresive, duke filluar me mungesat e shpeshta në shkollë, që më pas kthehen në braktisje të plotë dhe përfundimisht në shkëputje nga çdo formë e arsimit apo trajnimit. Mbështetja për nxënësit e kësaj grupmoshe do të shërbente si një mekanizëm parandalues, duke i mbajtur të rinjtë të angazhuar në sistemin arsimor përpara se ata të bëhen pjesë e statistikave NEET. Për më tepër, duke qenë se shkolla është vendi ku këta të rinj mund të identifikohen dhe mbështeten më lehtësisht, ruajtja e lidhjes së tyre me sistemin arsimor krijon mundësi më të mira për ndërhyrje të hershme dhe parandalim të përjashtimit të tyre të plotë social dhe ekonomik.

INSTAT raporton norma të larta NEET mes të rinjve, të cilat veçanërisht në kontekstin e braktisjes së shkollës së mesme të lartë, përfaqëson një sfidë kritike socio-ekonomike që kërkon vëmendje dhe adresim të menjëhershëm.

Pse është kjo e rëndësishme? - Vendimi për të lënë arsimin e mesëm të lartë para kohe ka pasoja të gjera për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Gjatë moshave vendimtare 15-19 vjeç, individët zhvillojnë jo vetëm njohuritë akademike, por edhe aftësitë e të menduarit kritik dhe kompetencat sociale që janë themelore për suksesin e tyre të ardhshëm. Braktisja e hershme e shkollës ndërpret këtë proces zhvillimi, duke krijuar boshllëqe që bëhen gjithnjë e më të vështira për t'u kapërcyer më vonë në jetë.

Implikimet ekonomike të braktisjes së shkollës së mesme të lartë shtrihen përtej pasojave individuale për të ndikuar në rezultatet më të gjera shoqërore:

1. Të ardhura të ulëta gjatë jetës: Individët që nuk përfundojnë arsimin e mesëm të lartë përballen me potencial dukshëm më të ulët të të ardhurave gjatë karrierës së tyre.

2. Akses i kufizuar në tregun e punës: Në një ekonomi gjithnjë e më të bazuar në njohuri, mungesa e një diplome të maturës shpesh shërben si pengesë për shumë mundësi pune.

3. Varësi e shtuar nga ndihma sociale: Braktisësit e hershëm të shkollës kanë më shumë gjasa të kërkojnë ndihmë sociale dhe përfitime papunësie gjatë gjithë jetës së tyre.

4. Të ardhura më të ulëta tatimore: Potenciali i reduktuar i fitimit përkthehet në kontribute më të ulëta tatimore, duke ndikuar në financat publike.

Përrjashtimi social dhe ndikimi ndër-gjeneracional i braktisjes së shkollës së mesme të lartë është serioz. Pasojat e braktisjes së hershme të shkollës shpesh krijojnë një cikël disavantazhesh:

- **Pengesa të lëvizshmërisë sociale:** Arsimi i kufizuar kufizon mundësitë e avancimit social
- **Efekte ndërgjeneracionale:** Fëmijët e braktisësve të hershëm të shkollës kanë më shumë gjasa të përballen vetë me sfida arsimore
- **Rezultatet shëndetësore:** Arritjet më të ulëta arsimore lidhen me shëndet me te dobët, më të pambrojtur dhe jetëgjatësi të reduktuar
- **Pjesëmarrja qytetare:** Braktisësit e hershëm të shkollës shpesh tregojnë norma më të ulëta të angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes politike

Reduktimi i normave të braktisjes së shkollës së mesme të lartë kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që adreson si pengesat e menjëhershme në arsim ashtu edhe faktorët themelore socio-ekonomikë. Zbatimi i suksesshëm i këtyre politikave kërkon angazhim të qëndrueshëm politik, alokimin e duhur të burimeve financiare për të ulur braktisjen në arsimin e mesëm, dhe monitorim e përshtatje të vazhdueshme të ndërhyrjeve. Përfitimet afatgjata të reduktimit të normave të braktisjes – përfshirë përmirësimin e kapitalit njerëzor, reduktimin e varësisë nga ndihma sociale dhe rritjen e produktivitetit ekonomik – tejkalojnë shumë investimin fillestar të kërkuar për zbatim. Për vende si Shqipëria, ku normat NEET mbeten të konsiderueshme, prioritizimi i mbajtjes së arsimit përfaqëson një hap vendimtar drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe përfshirjes sociale.

IV. Korniza strategjike dhe ligjore lidhur me braktisjen e arsimit në Shqipëri

4.1 Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026

Politikat mbështetëse aktuale trajtojnë kryesisht nxënësit deri në klasën e 9 të arsimit të detyrueshëm, por nevoja për të adresuar me mbështetje edhe arsimin e mesëm të lartë nuk ka mbetur pa vëmendje.

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 (SKA 2021-26) nënvizon se arsimi i mesëm i lartë nuk është i detyruar, por megjithatë karakterizohet nga një tërheqje mjaft të madhe të nxënësve nga arsimi bazë (rreth 95%). Llojet e arsimit të mesëm të lartë janë: gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi i mesëm i orientuar. Nxënësit që e frekuentojnë arsimin e mesëm të lartë i përkasin grupmoshës 15 – 18 vjeç.

Në dokumentin SKA 2021-26, një nga synimet është dhe [rritja e pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar](#) - ku, përkundër pjesëmarrjes së lartë nga arsimi bazë (rreth 92.5%), përfshirja është më e ulët se në vendet e tjera të Rajonit për shkak të braktisjes. Kujdesi i veçantë do t'i kushtohet vajzave dhe djemve në rrezik braktisje si dhe atyre nga grupet vulnerabël: fëmijëve me aftësi të kufizuara, vajzave dhe djemve që rikthehen nga emigracioni, fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe pjesëtarëve të pakicës rome dhe egjiptiane.

Sipas SKA 2021-26 kjo presupozon krijimin e sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mos-regjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë. SKA 2021 – 26 parashikon që në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të larta, si dhe në Zyra Vendore Arsimore Para universitare (ZVAP) të krijohen grupe për parandalim dhe reagim ndaj mos-regjistrimit dhe braktisjes, të përbëra nga mësuesit dhe përfaqësuesit e komunitetit.

SKA 2021-26 shpjegon se puna e këtyre grupeve do të udhëhiqet nga protokolle të veçanta, ato do mbështeten të rrisin kapacitetet identifikuese, ndërsa parashikohet të ndërtohet një sistem raportimi për rastet e mos regjistrimit dhe braktisjes së shkollimit. Gjithashtu, parashikohet të bëhet ofrimi i transportit për nxënësit e shkollave të mesme të larta në nevojë që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

Qëllimi i këtyre ndërhyrjeve është që të rritet pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë, prandaj nxënësve të këtij niveli që plotësojnë kriteret të caktuara do t'u ofrohet transporti falas deri në shkollë. Besohet se një masë e tillë do të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes së vajzave nga zonat rurale në arsimin e mesëm të lartë.

4.2 Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030 (SKPA 2023-30) nënvizon se qeveria shqiptare dhe institucionet e lidhura me punësimin, arsimin dhe aftësimin do të garantojnë që çdo i ri në grupmoshën 15 - 29 vjeç (NEET) të ketë një ofertë të denjë punësimi, trajnimi apo arsimit, brenda një periudhe të arsyeshme kohore nga momenti i identifikimit, në linjë me rekomandimet e Komisionit Evropian. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030 parashikon të ulë shkallën e NEET në nivelin 15% në vitin 2030, kur BE ka si objektiv që deri në vitin 2030 të ulët shkallën e të rinjve NEET të moshës 15-29 vjeç në 9 për qind nga 13.1 për qind në vitin 2021.

SKPA 2023-30 parashikon hartëzimin e të rinjve NEET si dhe zhvillimin e programeve dhe instrumentave për të parandaluar rritjen e numrit të të rinjve NEET duke u bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i *arsimit dhe formimit profesional* (AFP) - për këtë do të ngrihet një sistem monitorimi për braktisjen e hershme të shkollës dhe do të përforcohet shërbimi i këshillimit në karrierë brenda institucioneve arsimore. Në mënyrë më të detajuar SKPA 2023-30 në planin e saj *veprimit parashikon dhe ka realizuar:*

Tabelë 2: Parashikimi dhe realizimi i planit të veprimit të SKPA 2023-30

Planifikimi SKPA 2023-30	Ecuria e zbatimit gjatë 2023-2024 <i>(raporte, informacione, te dhena, burime online)</i>	Planifikuar për zbatim në vitet në vijim
Masa prioritare 2.1.2		
Tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës nga shkolla në punë për të rinjtë (NEET) nëpërmjet zbatimit të skemës së Garancisë Rinore		
Kryerjen e vlerësimit (vjetor) të profilit NEET në Shqipëri	Nuk ka nisur ende të kryhet ky proces	Koha e zbatimit TM1 2023 – TM4 2030
Zgjerimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm, i cili do të lejojë të vlerësohet rreziku i braktisjes pas	Në proces - Në bashkëpunim me UNICEF, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, si dhe partnerëve të tjerë të ekosistemit, po zbaton projektin “Qëndro”. Qëllimi i kësaj ndërhyrje është fuqizimi dhe angazhimi i nxënësve që janë në risk të braktisjes shkollore dhe NEET, me fokus të	Koha e zbatimit TM1 2023 – TM 4 - 2025

veçantë të vajzat. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 është punuar për krijimin e rrjeteve lokale dhe kombëtare për identifikimin e të rinjve në rrezik të braktisjes dhe zhvillimin e programeve të orientimit në karrierë, duke zbatuar një sistem paralajmërimi të hershëm për parandalimin e braktisjes në arsimin parauniversitar, duke përfshirë shkollat e AFP-së.

Për herë të parë në 14 shkolla të mesme profesionale në Shqipëri, Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm synon të adresojë parandalimin e braktisjes së shkollës në një mënyrë të strukturuar dhe të matshme. Stafi shkollor në 14 shkolla pilotuese është trajnuar dhe mentoruar nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë mbi zbatimin e Sistemit, duke kuptuar më mirë vështirësitë me të cilat mësuesit përballen nga nxënësit në rrezik braktisje dhe sfidat e lidhura me mbajtjen e tyre në shkollë.

Një tjetër aktivitet i zhvilluar për të adresuar riskun e braktisjes, është dhënia e granteve për shkollat në lidhje me zbatimin e projekteve shkollore, me ide të dhëna nga nxënësit e shkollave profesionale. Projektet nga të 14 shkollat përfshijnë bashkëveprimin e mësuesve, prindërve, konvikteve, komunitetit lokal, bizneseve lokale dhe institucioneve të bashkive.

Kurrikula dhe Manuali i Trajnimit & Zbatimit të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm & nxitjes së të nxënimit socio-emocional në shkollat e AFP

- Instrumente të sigurimit të cilësisë dhe të vetë/monitorimit për zbatimin e SPH në shkollat e AFP
- Paketa të modeleve për projekte me focus SPH dhe të nxënimit socio-emocional për parandalimin e braktisjes Keto janë kryer në shkollat e mesme profesionale, por jo në arsimin e mesëm të lartë jo-profesional

Në proces - Në mbështetje të nxënësve që rrezikohen nga braktisja, pjesë e grupeve të ngritura pranë shkollave janë psikologët/punonjësit sociale në total 33, të cilat janë emëruar në shkolla në zbatim të Urdhrit nr. 414, datë 26.7.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial" i ndryshuar" dhe organikave të miratuara nga ministria përgjegjëse për AFP-në. Nga këto grupe janë identifikuar rastet e nxënësve me rrezik braktisjes; janë kryer analiza krahasimore mbi numrin e braktisjeve gjatë vitit të kaluar dhe numrit të rasteve në rrezik braktisje të konstatuara si dhe janë mbajtur vazhdimisht në vëmendje nxënësit përsëritës.

Vlerësimin e zbatimit të masave të mbështetjes sociale për të reduktuar disavantazhet për akses në sistemin e arsimit dhe trajnimit

Në proces, por vetëm për arsimin e mesëm profesional - Për të rritur aksesin në arsimin profesional janë marrë masa për përmirësimin e bazës ligjore duke bërë ndryshimet në VKM nr.666, date 10.10.2019 i ndryshuar "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike (ku është përcaktuar qe te gjitha vajzat perfitojne gjysem burse, burse per ata qe ndjekin drejtime jo shume te kerkuara); si dhe është miratuar VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit"

Koha e zbatimit
TM1 2023 – TM4
2023

Zgjerimin e sistemit të menaxhimit të informacionit të tregut të punës për të gjuarmuar rrugëtimin e të rinjve NEET para, gjatë dhe pas përfshirjes në skemën e Garancisë Rinore

Në proces - Gjatë vitit 2023, AKPA ka nisur dizajnimin e Skedës së Garancisë Rinore në Sistemin informatik për monitorimin e Skemës dhe ndërtimi i nën-modulit të monitorimit përmes Sistemit Informatik të Shërbimeve të Punësimit. Sistemi do të vijojë të zhvillohet në vitin e ardhshëm.

Koha e zbatimit
TM1 2024 – TM4
2024



"Changing Lives Through Education" by Nehemiah Gateway USA. Available at:
<https://www.globalgiving.org/projects/in-albania-changing-lives-through-education/>

V. Politikat aktuale të mbështetjes dhe financimi i tyre - si funksionojnë ato në praktikë

Aktualisht politikat mbështetëse për fëmijët apo të rinjtë që braktisin, apo janë në rrezik për të braktisur shkollën trajtojnë nxënësit deri në moshën 15 vjeç që i përkasin arsimit të detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë. Në mbështetje të nenit 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹, të neneve 6, 19 e 28 të ligjit nr. 48/2018. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe një grup aktesh të tjera ligjore që trajtojnë kategori specifike të fëmijëve dhe nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar, me propozim të MAS dhe Ministrisë së Financave (MF), me qëllim që t’u vijë në ndihmë *“nxënësve, fëmijëve të familjeve në nevojë me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë”, është miratuar* Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike.

Miratimi i VKM nr.666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, trajton për herë të parë kategori specifike të fëmijëve dhe nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar, konkretisht

¹ Baza ligjore mbështetëse për zbatimin e VKM nr.666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike:

1. Neni 57 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji nr.48/2018 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, nenet 6, 19 e 28;
3. Ligji nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të pikës 2, neni 32;
4. Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore;
5. Ligji nr.10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës, nenet 1 e 5;
6. Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës, të ndryshuar, neni 2;
7. Ligji nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, neni 6,
8. Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, neni 8,
9. Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, neni 8;
10. Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në RSH, neni 32;
11. Ligji nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019.

të nxënësve, fëmijëve të familjeve në nevojë me ndikim në uljen e nivelit të "braktisjes shkollore", që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë.

Në pikën 2 të VKM nr.666, datë 10.10.2019 përcaktohet se: Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon (2.1 Sipas kriterit ekonomik):

a. Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre dhe që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që akomodohen në konvikte publike.

b. Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, dhe që akomodohen në konvikte publike.

c. Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë me ndikim në uljen e nivelit të "braktisjes shkollore", që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë.

Në zbatim të pikës 4 të VKM nr.666, datë 10.10.2019, "Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar mbi frekuentimin e procesit mësimor, nga drejtori i shkollës, si dhe nga ZVAP."

Financimi i politikave për të reduktuar braktisjen e shkollës në arsimin e detyrueshëm dhe atë të mesëm janë të përfshira në këto programe: "09120 – Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)" dhe "09230 – Arsimi i mesëm i lartë".

Numri total i bursave të miratuara nga MAS për të gjithë kategoritë përfituese, sipas VKM-së nr. 666/2019 për vitin shkollor 2023 – 2024 është si më poshtë:

- Në nivel kombëtar, janë miratuar 4,037 bursa (nga të cilat 3,804 të miratuara me fondet e MAS dhe 233 të miratuara me fondet e NJVV).
- MAS ka miratuar 3,804 bursa për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar, pa përfshirë nxënësit e arsimit profesional.
- Fondi për mbulimin e shpenzimeve për 3,804 bursa për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024, për 9 muaj x 7,320 lekë në muaj, është në vlerën 250,060,520 lekë.

VI. Identifikimi i fëmijëve/adoloshentëve që braktisin shkollën dhe aktorët që përfshihen në këtë proces

Të dhënat e disponueshme statistikore mund të fitojnë vlerë të praktikueshme vetëm nëse ato përforcohen dhe përditësohen në kohë reale me përfshirjen e institucioneve që kanë kompetencë ligjore në nivel qendror dhe sidomos në nivel lokal, - të cilat kujdesen për problematikën e fëmijëve që braktisin shkollën, apo janë në rrezik për braktisjen e shkollës në arsimin e mesëm të lartë. Dinamikat e këtyre situatave përfshijnë, së paku, katër kategori të fëmijëve jashtë shkollës ose në rrezik për ta braktisur atë:

- *Fëmijë jashtë shkolle të dukshëm:* fëmijët e moshës shkollore të cilët nuk e ndjekin shkollën por janë të regjistruar në bazat e të dhënave arsimore; këta janë përgjithësisht fëmijë që e kanë braktisur shkollën.
- *Fëmijë jashtë shkolle gjysmë të padukshëm:* fëmijët e moshës shkollore të cilët nuk e kanë ndjekur kurrë shkollën por të dhënat e tyre janë në një ose më shumë baza të dhënash të qeverisë; është i mundur identifikimi i tyre duke lidhur të dhënat e regjistrimit me këto baza të dhënash të qeverisë në nivelin e çdo fëmije.
- *Fëmijë jashtë shkolle të padukshëm:* fëmijët e moshës shkollore të cilët nuk e kanë ndjekur kurrë shkollën dhe që nuk janë regjistruar në asnjë nga bazat e të dhënave të qeverisë; prandaj është e vështirë që këta fëmijë të gjenden dhe të identifikohen.
- *Fëmijët në rrezik:* fëmijët e moshës shkollore të cilët janë në shkollë por janë në rrezik për ta braktisur atë.

Specifikat e grupeve të mësipërme janë të ndryshme dhe të tilla janë dhe mënyrat për zgjidhjen e tyre. Lëvizjet e shpeshta migratore brenda dhe jashtë vendit e vështirësojnë edhe më tej evidentimin e nxënësve jashtë shkolle dhe trajtimin e rasteve sipas specifikave të mësipërme.


Institucionet në nivel vendor të cilat mund të përfshihen në identifikimin e fëmijëve që braktisin, apo janë në rrezik të braktisin shkollën paraqitën në grafikën e mëposhtme:

Grafik 1: Lista e institucioneve në nivel vendor të cilat mund të përfshihen në identifikimin e fëmijëve që braktisin, apo janë në rrezik të braktisin shkollën



Një skemë e mundshme e mekanizmit për shkëmbimin në kohë të informacionit mes këtyre Institucioneve (në nivel qendror dhe vendor) për të identifikuar sa më saktë fëmijëve që braktisin, apo janë në rrezik të braktisin shkollën, paraqitet në figurën e mëposhtme:

Grafik 2: Një skemë e mundshme e mekanizmit për identifikimin e fëmijëve që braktisin, apo janë në rrezik për NEET



Lista 1: Lista emërore e fëmijëve të moshës 15–18 vjeç, që jetojnë brenda vendit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Lista 2: Lista emërore të fëmijëve dhe të rinjve 15–16 vjeç që janë regjistruar në klasën e 9 të arsimit të detyruar (publik dhe privat), 16–18 vjeç që janë regjistruar në arsimin e mesëm të lartë (publik dhe privat) nëpërmjet e-Albania dhe SMIP

Lista 3: Lista emërore e fëmijëve në institucionet publike rezidenciale të përkujdesit social për fëmijë që janë largues të hershëm nga shkolla

Lista 4: Lista emërore e fëmijëve dhe të rinjve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale, qendrat shumëfunktionale të AFP-së dhe qendrat e formimit profesional

VII. Propozimi për të mbështetur

Amendimi i Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” duke shtuar në të edhe një kategori të re specifike (2.1.d) të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar të mesëm të lartë, konkretisht të nxënësve që vijnë nga familje në nevojë me ndikim në uljen e nivelit të “largimeve nga shkolla”, që që janë të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin e mesëm të lartë.